



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3506/6 prot.

Datë 16.12.2025

V E N D I M
Nr.1862/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.12.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër 3506/2025 prot., datë 09.12.2025 i operatorit ekonomik BOE “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-64195-10-09-2025, me objekt: “Ndertimi i varrezave të Qytetit të Lezhës, në fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhë, LOTI 1”, me fond limit 40,990,536.70 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

Ankimues:

Operatori ekonomik BOE “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, me NIPT J62904264O, J62903384G e K81314023A dhe adresë: Fshati Balez Poshte, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11, 1 km nga kryqezimi i fshatit Kusar, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Lezhë me adresë: Lagjia “Skenderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II**Rrethanat e çështjes.**

II.1. Në datën 10.10.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e

prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-64195-10-09-2025, me objekt: “Ndertimi i varrezave te Qytetit te Lezhes, ne fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhe, LOTI 1”, me fond limit 40,990,536.70 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

II.2. Në datën 04.08.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 10.09.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

BE – IS	33,760,125	lekë	Skualifikuar
Bonus	29,519,658	lekë	Skualifikuar
BOE Colombo LTD & Eral Construction Company	33,861,555	lekë	Kualifikuar
BOE Kegli-Duri & Lis Konstruksion	31,977,330	lekë	Skualifikuar
Nika	34,842,675	lekë	Kualifikuar
BOE Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” & “Blerimi” & “Martini Konstruksion & Real Estate”	30,107,619.29	lekë	Skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 02.12.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 08.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/6149 dhe nr.3506/2025 prot, datë 09.12.2025 i operatorit ekonomik BOE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, i cili lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vleresimit te ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3506/1, datë 09.12.2025.

II.7. Në datën 12.12.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, si përfaqësues i BOE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, me shkresën me nr.131 prot., datë 12.12.2025, me objekt “Kërkesë për tërheqje nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.3506/2025 prot., datë 09.12.2025 për procedurën e prokurimit.....”, protokolluar me tonën me nr.3506/2 prot., datë 12.12.2025, ka paraqitur pranë Komisionit të

Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-64195-10-09-2025, me objekt: “Ndertimi i varrezave te Qytetit te Lezhes, ne fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhe, LOTI 1”, me fond limit 40,990,536.70 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë, duke u shprehur se:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa nr. 3506/2025 prot, më datë 09.12.2025 e paraqitur nga shoqëria Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a me objekt si më poshtë, Autoritet Kontraktor: Bashkia Lezhë, objekti i procedurës: "Ndertimi i varrezave te Qytetit te Lezhes, ne fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhe, LOTI 1", me numër reference REF-64195-10-09-2025, me fond limit 40.990.536,70 lekë pa tvsh, Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të Ligjit të Prokurimit Publik, deklaroj dhe kërkoj Heqjen dorë nga shqyrtimi i ankesës të paraqitura si më sipër cituar.”.

II.8.Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.21209/3 prot., datë 15.12.2025, me objekt “Kthim Përgjigje”, protokolluar me tonën me nr.3506/3prot., datë 16.12.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr.1, datë 15.12.2025, të personit të caktuar për shqyrtimin e ankesës, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues BOE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues, BOE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-64195-10-09-2025, me objekt: “Ndertimi i varrezave te Qytetit te Lezhes, ne fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhe, LOTI 1”, me fond limit 40,990,536.70 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.1.1 Në datën 26.09.2025, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK, si përfaqësues i BOE “Rruga Ura Asfaltim

Nr.2 Elbasan” & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, me shkresën me nr.131 prot., datë 12.12.2025, me objekt “Kërkesë për tërheqje nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.3506/2025 prot., datë 09.12.2025 për procedurën e prokurimit.....”, protokolluar me tonën me nr.3506/2 prot., datë 12.12.2025, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-64195-10-09-2025, me objekt: “Ndertimi i varrezave te Qytetit te Lezhes, ne fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhe, LOTI 1”, me fond limit 40,990,536.70 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë, duke u shprehur se:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa nr. 3506/2025 prot, më datë 09.12.2025 e paraqitur nga shoqëria Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan sh.a me objekt si më poshtë, Autoritet Kontraktor: Bashkia Lezhë, objekti i procedurës: "Ndertimi i varrezave te Qytetit te Lezhes, ne fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhe, LOTI 1", me numër reference REF-64195-10-09-2025, me fond limit 40.990.536,70 lekë pa tvsh, Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të Ligjit të Prokurimit Publik, deklaroj dhe kërkoj Heqjen dorë nga shqyrtimi i ankesës të paraqitura si më sipër cituar.”.

III.1.2. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.3. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. KPP konstaton se, operatori ekonomik Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan SHPK, i cili ka paraqitur tërheqjen nga ankesa, është paraqitur në procedurën e prokurimit objekt ankimi në cilësinë e përfaqësuesit të bashkimit të perkohshëm të operatorëve ekonomikë BOE “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK. Referuar, nenit 3 “Përfaqësimi i palëve”, të Marrëveshjes së bashkëpunimit, datë 27.10.2025, të lidhur mes operatorëve ekonomikë “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, rezulton se, operatori ekonomik “Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK është përcaktuar si përfaqësues i këtij bashkimi të perkohshëm të operatorëve ekonomikë, i cili ndër të tjera ka të drejtë të paraqesë ankesa, kërkesa, padi civile apo administrative, kallzime administrative në çdo institucion si APP, KPP Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë

menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 3506/2025 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, BOE “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-64195-10-09-2025, me objekt: “Ndertimi i varrezave të Qytetit të Lezhës, në fshatin Merqi, Njesia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhë, LOTI 1”, me fond limit 40,990,536.70 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik, BOE “Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan” SHPK & “Blerimi” SHPK & “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

